



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1210/1 Prot.

Tiranë, më 28.09.2017

Vendim
Nr. 28, datë 28.09.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PUNËSIMIN
E SANITARES NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Bazuar në nenin 49/f të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 28.09.2017

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret dhe procedurat për pozicionin Sanitare (një vend i lirë) si më poshtë:

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë nga ana higjeno-sanitare dhe funksionale sipërfaqet e ambjenteve të brendshme, të jashtme dhe të ambjenteve hidro-sanitare (tualetëve), që janë në administrim të Univeristetit "Ismail Qemali", Vlorë.

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË APLIKANTI

- Të ketë eksperiencë pune.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe koordinimi.
- Të zotërojë minimalisht diplomë të arsimit baze.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATET E DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, dokumentet si më poshtë:




REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

- Leter interesi që shpjegon përshtatshmërinë për pozicionin.
- Jetëshkrimin.
- Kopje të diplomës dhe të listës së notave (noterizuar).
- Kopje të librezës së punës (noterizuar).
- Fotokopje të kartës së identitetit ID.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
- Deklaratë e kandidatit për mos pasjen e konfliktit të interesit me Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- Aplikantët të cilët i dorëzojnë dokumentat të pa noterizuara, ose kanë mangësi në dokumentacion skualifikohen menjëherë.
- Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën: Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Zyra e protokollit.
- Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumenteve është 14 ditë, nga dita e publikimit të njoftimit në A.P.P, Tiranë.

PROCEDURA QË DUHET TË NDIQET

- Pas njoftimit të procedurës së punësimit, Rektori urdhëron ngritjen e komisionit *ad-hoc* pranë rektoratit për përzgjedhjen e personelit administrativ. Komisioni do të kryesohet nga Administratori, Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit si dhe nga Drejtori i drejtorisë përkatëse ku do të punësohet aplikanti.
- Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, por jo më vonë se 2 (dy) ditë, Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit, mer në dorëzim gjithë dosjet e kandidatëve dhe ia përcjell komisionit listën e kandidatëve me dokumentacionin përkatës.
- Skema e vlerësimit hartohet me vendim të Komisionit *ad-hoc* dhe miratohet nga Rektori.
- Vlerësimi i mësipërm kryhet nga çdo anëtar i Komisionit *ad-hoc* për secilin kandidat. Në përfundim, mblidhen pikët e dhëna nga anëtarët e Komisionit për të njëjtin kandidat dhe hartohet klasifikimi paraprak.
- Pas vlerësimit paraprak kryhet intervista me kandidatët e klasifikuar, të cilët njoftohen në numrin personal të telefonit të deklaruar dhe adresën e-mail-it të



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

deklaruar prej tyre, nga Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit për datën dhe orën e zhvillimit të intervistës.

- Komisioni ad-hoc vëzhgon dhe vlerëson performancën e komunikimit dhe njohuritë e kandidatëve sipas kriterëve përkatëse të vendit të punës të kandidatëve dhe i vlerëson ata me pikë, sipas sistemit të pikëzimit.
- Komisioni ad-hoc plotësojnë pasqyrën përmbledhëse të rezultateve të konkurimit në të dy fazat dhe së bashku me gjithë dokumentacionin përkatës ia përcjellin Rektorit.
- Sektori i Burimeve Njerëzore bën njoftimin e kandidatit fitues dhe atyre që nuk përzgjidhen (jo fitues).
- Kandidatët jo fitues kanë të drejtën e ankimit tek Rektori brenda 5 ditëve pas marrjes së vendimit të komisionit.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

3. Ngarkohet Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentit Zyrtar të bëjë shpalljen për konkurim të hapur për pozicionin e mësipërm në web-site e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, dhe APP.

1. Rezana Vrapit – Kryetar

2. Florian Nurçe – anëtar

3. Enida Pulaj – anëtar

4. Eduard Ahmeti – anëtar

5. Elsajed Rexhaj – anëtar

6. Ornela Koleka - anëtar

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.